



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Illir Halili</b>	<b>25.03.2026</b>	<b>08.04.2026</b>	<b>2026/0179</b>

### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.03.2026, OE “ALL STONE SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0179, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “MARRJA ME QERA E MAKINERIVE TE RENDA” me nr. të prokurimit: "214/30400-25-11613-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Parashtruesi i ankesës, konsideron se nga ana e AK-së, POLICIA E KOSOVËS, vlerësimi për këtë aktivitet të prokurimit është bërë në kundërshtim me parimet e prokurimit publik, rrjedhimisht duke shkelur dispozitat përkatëse të LPP-së Nr. 02/L-042 (verzioni i konsoliduar) si ligj material dhe legjislacionit sekondar Rregullore për Prokurim Publik Nr.002/2024, në mënyrë specifike dispozitat si më poshtë:  
? Neni 1 par. 1 dhe 2 të LPP-së

? Neni 7 të LPP-së

? Neni 52 par. 1 dhe 3 të LPP-së

? Neni 56 paragrafi 1.1, 1.2 dhe 3 të LPP-së

? Neni 59 par. 1, 2 dhe 4 të LPP-së

? Neni 60 par. 1.1 të LPP-së

? Neni 61 të LPP-së

? Neni 69 të LPP-së

? Neni 72 të LPP-së

? Neni 4.1 të RrPP-së

? Neni 25 të RrPP-së

? Neni 27 të RrPP-së

? Neni 38 të RrPP-së

? Neni 40 të RrPP-së

? Neni 41 të RrPP-së

? Neni 61 të RrPP-së

? Neni 97 par.1.o) të RrPP-së

? Dispozita nr. 9 dhe 10 të UPP-së

Njëkohësisht AK me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim ka bërë shkelje edhe të Nenit 108/A të LPP-së.

istoria procedurale e çështjes së aktivitetit në fjalë

1. Me datën 1 Janar 2026, AK – “POLICIA E KOSOVËS” përmes platformës publike eprokurimi ka shpallur iniciimin e aktivitetit të prokurimit me titull: “MARRJA ME QERA E MAKINERIVE TE RENDA” me nr. prokurimi: 214/30400-25-11613-2-2-1.

2. Kompania jonë, pra Operatori Ekonomik ALL STONE SH.P.K. ka marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit duke dorëzuar dosjen e tenderit brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe duke i plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Në këtë aktivitet të prokurimit janë pranuar 4 oferta.

Nr. Operatori Ekonomik Çmimi (me poentim)

1 Company Murseli SH.P.K. 98.80 €

2 ALL STONE SH.P.K. 199.66 €

3 ETEAM SH.P.K. 258.83 €

4 DARDANIAA SH.P.K. 1,360.00 €

3. Autoriteti Kontraktues me datën 27.02.2026 ka bërë publikimin e Njoftimit mbi

Vendimin e AK-së, tek i cili vendim AK rekomandon anulimin e aktivitetit me arsyetimin se të gjitha ofertat janë të papërgjegjshme, duke mos zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së.

4. Menjëherë pas pranimit të këtij Vendimi ne kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare me dt. 27.02.2026 ku pastaj qasja është mundur me 02.03.2026.

Pas analizimit të këtyre dokumenteve mund të thuhet se gjatë procedurës formale të vlerësimit të tenderëve që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet prokurimi, nxjerrjes së vendimeve kontradiktore, AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së për shkak se gjatë mënyrës dhe metodës se vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe dispozitat ligjore që përcaktojnë kushtet dhe kërkesat e trajtimit të barabartë të OE në procesin e vlerësimit.

Në vazhdim do të ofrojmë një deklaratë të qartë, të detajuar dhe të faktuar me argumente të bazuara dhe mbështetshme për secilën nga pretendimet ankimore që do t'i parashtrojmë në këtë "Ankesë" kundrejt vendimit të AK sipas të cilave mund të vëreni shumë lehtë se AK ka vepruar në kundërshtim me LPP-në duke mos i përfillur kërkesat që vet i ka parashtruar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë lidhur me kriteret e përzgjedhjes dhe kriterit të dhënies së kontratës duke shkelur parimet bazike dhe parimet

e vlerësimit të prokurimit.

Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore

Pretendimet për shkelje procedurale/materiale gjatë veprimeve dhe aktvendimit të AK-së për refuzimin si të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim

Nga ana e Sektorit të Prokurimit të AK-së, përmes vendimit të datës 12.03.2026 te e cila është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga ne, me një arsyetim të përgjithshëm dhe të paargumentuar me asnjë fakt dhe provë konkrete.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së kanë ndodhur një mori shkelje procedurale dhe materiale të cilat do t'i paraqesim në vijim:

Konstatimet e paraqitura në të gjitha pikat e vendimit të AK-së janë të mangëta dhe si të tilla nuk janë të bazuara dhe argumentuara me faktet vendimtare në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara nga ne, kërkesave të dosjes së tenderit dhe dispozitave ligjore të LPP-së. Nga ky vendim shihet qartë se AK i ka trajtuar shkarazi dhe në mënyrë selektive pretendimet dhe argumentet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, ashtu që duke u shmangur detyrimeve ligjore dhe duke i anashkaluar faktet vendimtare dhe rrethanave të rastit konkret ka paraqitur pasqyrim të gabuar të gjendjes faktike që nuk përkon me realitetin, rrjedhimisht që e ngatërron gjendjen e saktë faktike dhe përshkrimit ligjor në mënyrë që të na mohoj të drejtën në rivlerësim të drejtë të procesit, me qëllim që të ipet përshtypja se asgjë e paligjshme nuk ka ndodhur. Prandaj, ky arsyetim i vendimit të atakuar nuk e ka vërtetuar saktë dhe drejtë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta e dispozitave materiale të LPP-së (Neni 108/A) përfshirë edhe keqinterpretimi i tyre dhe kërkesave të dosjes së tenderit.

Sepse arsyet e dhëna në vendimin e AK-së nuk janë të bazuar në baza ligjore sipas dispozitave të LPP-së dhe pjesës përbërëse të legjislacionit dytësor RRPP Nr.001/2022. Për më tepër arsyetimi i vendimit të AK-së është në kundërshtim edhe me përcaktimet e nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Po ashtu, një ndër shkeljet thelbësore në këtë procedurë është fakti se nga ana e AK-së nuk

është përcaktuar asnjë çmim referent apo vlerë e parashikuar për pozicionet përkatëse të tenderit, për shkak të natyrës specifike të tyre, ku në praktikë dhe në rrethana të tilla nuk mund të vendoset çmim referent i saktë dhe i qëndrueshëm.

Në mungesë të një çmimi referent apo vlere të parashikuar, AK ka qenë e obliguar që vlerësimin e ofertave ta bëjë në mënyrë objektive, të paanshme dhe duke u bazuar në analiza reale të tregut dhe në përputhje me parimet themelore të prokurimit publik, e jo në vlerësime subjektive apo të paargumentuara.

Mirëpo, nga vendimi i kontestuar rezulton se AK ka bërë vlerësime arbitrare lidhur me çmimet e ofertuara, pa ofruar asnjë analizë krahasimore, dëshmi të tregut apo bazë tjetër të matshme që do të justifikonte konstatimet e saj. Një qasje e tillë bie ndesh me parimin e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë, siç përcaktohet në

dispozitat përkatëse të LPP-së.

ër më tepër, mungesa e çmimit referent e bën të pamundur çdo konstatim të qëndrueshëm lidhur me "çmime jonormale" apo devijime eventuale, andaj çdo pretendim i AK-së në këtë drejtim është i pabazuar dhe në kundërshtim me praktikën dhe standardet e prokurimit publik.

Rrjedhimisht, duke mos pasur një bazë të qartë krahasuese dhe duke mos arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme vendimin e saj, AK ka dështuar të vërtetojë drejt dhe saktë gjendjen faktike, duke rezultuar në një vendimmarrje të gabuar dhe në kundërshtim me dispozitat materiale dhe procedurale të legjislacionit në fuqi.

Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore

Pretendimet ankimore mbi Vendimin e AK-së i datës 27.02.2026

Pretendimi i parë (1)

Autoriteti Kontraktues ofertën tonë e cilëson si të papërgjegjshme me arsyetimin se:

**OE është i papërgjegjshëm për pikat në vijim:**

**1. Sipas nenit 4.1 pikës C të rregullore nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik cila thotë Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim: sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut ju keni ofruar me çmime shumë herë me te lart se sa çmimet reale te tregut dhe çmimet e parashikuar nga AK për artikujt në vijim:**

**Pjesa A: Pz.2.**

**Pjesa B: Pz.1, Pz.2, Pz.3, Pz.4,**

**Pjesa C: Pz.1, Pz.2, Pz.3, Pz.4, Pz.5.**

**Komisioni I vlerësimit ka kërkuar sqarim nga OE se si ka arritur të këto çmime për artikujt e larte përmendur .**

**Komisioni I vlerësimit ka pranuar përgjigje në lidhje me sqarimet e kërkuar pas vlerësimit të sqarimeve të dhëna nga OE, për komisionin e vlerësimit nuk janë bindëse sqarimet e dhëna nga OE sepse për artikujt e larte përmendur çmimet e ofruara nga OE janë shumë të larta në krahasim me vlerën e parashikuar nga ana e AK.**

**Duke ju referuar edhe interpretimit të KRPP AK në harmoni të plot me LPP ka kërkuar sqarime gjate fazës së parë të vlerësimit mbi çmimet shumë herë me te larta se sa ato reale në treg dhe OE ka ofruar vetëm një zbërthim por asnjë dëshmi apo dokumentim se si ka arritur deri tek formulim i këtyre çmimeve  
Andaj oferta juaj është e papërgjegjshme.**

Këto arsyetime nuk janë të bazuara dhe nuk e pasqyrojnë realitetin dhe gjendjen faktike por si të tilla paraqesin fakte të rreme me qëllim të justifikimit të këtij vendimi i cili është në kundërshtim me parimet dhe kriteret e nenit 59, nenit 69 të LPP-së lidhur me nenin 40 paragrafi 1,2 dhe 6 të RrPP nr. 001/2022.

Së pari, AK nuk ka realizuar asnjë hulumtim të tregut. Arsyetimi i eliminimit që është theksuar është vetëm një kamuflim që të jepet përshtypje se asgjë e paligjshme nuk po ndodhë që të arrihet rezultati i dëshiruar nga ana e AK-së.

Së dyti, AK me dt. 28.01.2026 ka kërkuar sqarime në lidhje me çmimet e ofruara nga ana jonë dhe ne me dt. 30.01.2026 kemi dorëzuar një sqarim detaj lidhur me këto çmime. Në këtë kërkesë për sqarime në çmim AK ka vlerësuar të gjitha pozicionet (përveç pozicionit A.1.) si pozicione me çmime të larta sipas tyre ndërsa nuk ka paraqitur asnjë hulumtim

tregu dhe si janë bërë krahasimet e çmimeve për të konkluduar se këto janë çmime të larta sipas Nenit 4.1.c., mirëpo edhe përkundër kësaj ne kemi paraqesim një shpjegim detal lidhur me këtë çështje.

Së treti, sipas dispozitave procedurale dhe qenësore të LPP-së gjegjësisht nenit 59.4 të këtij ligji lidhur me nenin 41 të RrPP-së, AK është i autorizuar të bëjë vlerësimin e tenderëve në pajtim me këtë ligj, si dhe në pajtim me të gjitha dispozitat e legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj duke u bazuar në kërkesat të cilat i ka paraqitur në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Dhe në këtë kuptim kushtet e përcaktuara për pjesëmarrje të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë AK nuk ka paraqitur asnjë kërkesë lidhur me ÇMIMET REFERENTE për pjesët e tenderit (sipas paramasës dhe paralogarisë së punëve) – Çmim TAVAN që përcakton nivelin minimal dhe maksimal të çmimit dhe OE duhet të mbështeten gjatë përgaditjes së ofertave financiare dhe që AK duhet të mbështetet gjatë kalkulimit dhe vlerësimit të tenderëve që do të ju shërbenin si mjet ndihmës. Atëherë duke pasur parasysh se në dosjen e tenderit nuk janë paraqitur çmimet referente që OE duhet të mbështeten gjatë përgaditjes së ofertës financiare dhe poashtu nuk është i vendosur një min. apo max. i çmimit tavan siç është vendosur tavani i çmimit maksimum në vlerën e parashikuar të kontratës, shtrohet pyetja se mbi cilën bazë është mbështetur dhe ka vendosur AK që ta vlerësojë një "çmim të lartë" kur as nuk plotësohet kushti ligjor e as nuk e ka të përcaktuar në kushtet e pjesëmarrjes të DT.

Fillimisht para se të paraqesim dëshmitë tona në lidhje me këto pozicione ju njoftojmë se oferta jonë nuk mund të konsiderohet si ofertë jo-normalisht e ulët/lartë siç përcaktohet me Nenin 41.3 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik dhe nuk dihet qëllimi i AK-së se pse ofertën tonë e ka konsideruar si të tillë.

a) Pozicioni A.2. Hapja e kanaleve me paisje te renda Eskavator te peshave te renda minimum 25 tone. Ne qmim duhet te llogaritet transporti I makinerise deri ne vendin ku do te kryhen punimet,pra makineria e cila bene hapjen e

kanaleve llogaritet qmimi vetem prej fillimit te kryerjes se punimeve.

Çmimi i ofruar njesi: 285.00€/orë.

Lidhur me pozicionin A.2, sqarojmë se bëhet fjalë për kontratë publike kornizë, për të cilën nuk është i njohur paraprakisht lokacioni i punimeve, kohëzgjatja e ndërhyrjes apo distanca e transportit të makinerisë, çka paraqet rrezik ekonomik të drejtpërdrejtë për operatorin ekonomik. Në përshkrimin e pozicionit është përcaktuar qartë se në çmim duhet të përfshihet transporti i makinerisë deri në vendin e punimeve, ndërsa pagesa llogaritet vetëm nga fillimi i kryerjes së punimeve, pa u kompensuar koha dhe kostoja e transportit.

Eskavatorët me peshë minimale 25 ton kanë kosto të larta operative, duke përfshirë shpenzime të konsiderueshme të naftës (konsum i lartë për orë pune), servis të specializuar, amortizim të shpejtë të pajisjes si dhe kosto shtesë për transport me mjete të posaçme. Në praktikë, mund të kemi raste kur makineria transportohet në distanca deri në 80 km, ndërsa ndërhyrja në terren zgjat vetëm 1-2 orë, për çka operatori ekonomik paguhet vetëm për kohën e punës, p.sh. 570 € për 2 orë, ndonëse kostoja reale e shërbimit është dukshëm më e lartë.

Për më tepër, duhet pasur parasysh edhe rreziku që lidhet me lokacionin e zhvillimit të punimeve, përfshirë mundësinë e dëmtimit të pajisjes dhe rrethanat e paparashikueshme të sigurisë, të cilat paraqesin rrezik shtesë dhe mbesin përgjegjësi e operatorit ekonomik. Për këto arsye, çmimi i ofruar prej 285.00 €/orë është plotësisht i arsyetuar ekonomikisht, reflekton rrezikun, kostot reale dhe natyrën e kontratës kornizë dhe nuk mund të konsiderohet çmim jo-normalisht i lartë sipas legjislacionit në fuqi.

b) Pozicioni B.1. Mbajtja ne posedim te paisjeve te peshave te renda minimum30 tone Bulldozher me goma ose zingjir ,ne qmim te llogaritet vetem prej momentit te dorezimit te makineris ku do te jete ne mbajtje.

Çmimi i ofruar njesi: 13.80€/orë.

c) Pozicioni B.2. Mbajtja ne posedim te paisjeve transportues te peshave

terenda minimum 35 tonë ,ne qmim te llogaritet vetem prej momentit te

dorezimit te makineris ku do te jete ne mbajtje. Çmimi i ofruar njesi:

13.50€/orë.

d) Pozicioni B.3. Mbajtja ne posedim e paisjeve te peshave te renda per

ngarkim(luge)minimum 25 tone ,ne qmim te llogaritet vetem prej momentit

te dorezimit te makineris ku do te jete ne mbajtje. Çmimi i ofruar njesi:

14.50€/orë.

e) Pozicioni B.4. Mbajtja ne posedim e paisjeve te peshave te renda per

ngarkim(luge)minimum 25 tone ,ne qmim te llogaritet vetem prej momentit

te dorezimit te makineris ku do te jete ne mbajtje. Çmimi i ofruar njesi:

15.50€/orë.

Lidhur me pozicionet B.1, B.2, B.3 dhe B.4, sqarojmë se të gjitha këto pozicione kanë të

njëjtën natyrë shërbimi, përkatësisht mbajtjen në posedim të pajisjeve të rënda, dhe jo

përdorimin apo operimin aktiv të tyre. Në përshkrimin e secilit pozicion është përcaktuar

qartë se çmimi llogaritet vetëm nga momenti i dorëzimit të makinerisë, ndërsa transporti,

përgatitja teknike, mirëmbajtja, sigurimi dhe gatishmëria teknike mbesin barrë e operatorit

ekonomik.

Mbajtja në posedim e pajisjeve të rënda (bulldozer min. 30 ton, mjete transportuese min. 35

ton dhe pajisje për ngarkim min. 25 ton) nënkupton kosto të vazhdueshme dhe të

pashmangshme, duke përfshirë amortizimin e makinerisë, shpenzimet e mirëmbajtjes,

sigurimin, personelin teknik në gatishmëri si dhe bllokimin e pajisjeve nga angazhime të

tjera komerciale. Për më tepër, duke qenë se bëhet fjalë për kontratë publike kornizë,

kohëzgjatja e mbajtjes në posedim nuk është e paracaktuar, çka rrit rrezikun ekonomik për

operatorin ekonomik.

Çmimet e ofruara për këto pozicione (13.80 €/orë, 13.50 €/orë, 14.50 €/orë dhe 15.50 €/orë)

janë çmime minimale dhe ekonomike, të përshtatura sipas llojit dhe peshës së pajisjes, dhe

përfaqësojnë vetëm një kompensim bazik për kostot e mbajtjes në posedim. Si të tilla, këto

çmime janë të favorshme për Autoritetin Kontraktues, të arsyetuara ekonomikisht dhe nuk mund të konsiderohen çmime jo-normalisht të larta, por përkundrazi çmime proporcionale dhe konkurruese në raport me natyrën e shërbimit dhe kushtet e kontratës. Për ilustrim praktik, në rast se një buldozer apo pajisje ngarkuese mbetet në mbajtje për 24 orë, kostoja totale që do të paguhej sipas çmimeve të ofruara do të ishte rreth 330–370 € në ditë, varësisht nga lloji i pajisjes. Kjo shumë përfaqëson vetëm një kompensim minimal për mbajtjen në posedim të makinerisë dhe nuk reflekton vlerën reale të shfrytëzimit të saj në treg.

Nëse e njëjta pajisje do të angazhohej në projekte të tjera publike apo private, edhe vetëm 1-2 orë punë aktive do të gjeneronin të ardhura dukshëm më të larta sesa kompensimi ditor për mbajtje në posedim sipas kësaj kontrate. Megjithatë, për shkak të natyrës së kontratës kornizë, operatori ekonomik bllokon makinerinë dhe e mban atë në gatishmëri, duke hequr dorë nga mundësitë e tjera komerciale, për një kosto që është dukshëm e ulët dhe shumë e favorshme për Autoritetin Kontraktues. Për më tepër, gjatë mbajtjes në posedim duhet pasur parasysh edhe rreziku i dëmtimit apo humbjes së pajisjeve, si dhe rreziqet që lidhen me vendndodhjen dhe ambientin e veprimit të tyre, përfshirë rrethanat e paparashikueshme të sigurisë, të cilat mbesin përgjegjësi e operatorit ekonomik.

Si rrjedhojë, ky rast praktik dëshmon qartë se çmimet e ofruara për pozicionet B.1 - B.4 nuk janë çmime të larta, por përkundrazi çmime minimale, të cilat reflektojnë vetëm mbulimin bazik të kostove të mbajtjes në posedim të pajisjeve të rënda.

f) Pozicioni C.1. Transportimi i pajisjeve të rënda me Transporter të peshave të rënda minimum 35 tone, ku në qmim llogaritet ngarkimi, transporti dhe shkarkimi, llogaria behet prej momentit të ngarkimit deri në destinacion.  
Çmimi i ofruar njësi: 14.90€/km.

g) Pozicioni C.2. Transportimi i kontejnereve dhe pajisjeve tjera me kamion me kran minimum 5 ton për km, ku në qmim llogaritet ngarkimi, transporti dhe shkarkimi, llogaria behet prej momentit të ngarkimit deri në destinacion.

Çmimi i ofruar njesi: 15.75€/km.

h) Pozicioni C.3. Transportimi I makinerive te ndryshme per km,ku ne qmim

llogaritet ngarkimi,transporti dhe shkarkimi,llogaria behet prej momentit te

ngarkimit deri ne destinacion. Çmimi i ofruar njesi: 15.15€/km.

i) Pozicioni C.4. Transportimi i automjeteve te pa levizshme me peshe bartese

minimum 10 ton me autobartese kran ,qmimi llogaritet prej momentit te

ngarkimit deri ne destinacion. Çmimi i ofruar njesi: 16.25€/km.

j) Pozicioni C.5. Transportimi I reres apo dheut ,sipas nevojës me kamion deri

ne 20 ton,ne qmim duhet te llogaritet prej momentit te ngarkimit deri ne

destinacion per km. Çmimi i ofruar njesi: 9.95€/km.

Lidhur me pozicionet C.1, C.2, C.3, C.4 dhe C.5, sqarojmë se të gjitha këto pozicione kanë

të njëjtën natyrë shërbimi, përkatësisht transportimin e pajisjeve, makinerive dhe

materialeve, ku në çmim përfshihet ngarkimi, transporti dhe shkarkimi, ndërsa llogaritja

bëhet nga momenti i ngarkimit deri në destinacion, sipas përshkrimit të pozicioneve në

paramasë.

Transportimi i pajisjeve dhe makinerive të rënda nënkupton kosto të konsiderueshme

operative, duke përfshirë shpenzime të larta të karburantit, amortizimin e mjeteve

transportuese, mirëmbajtjen, sigurimin, personelin e kualifikuar (shoferë dhe operatorë

krani), si dhe përdorimin e mjeteve të specializuara si transporterë të peshave të rënda,

kamionë me kran dhe autobartëse. Për më tepër, natyra e kontratës publike kornizë

nënkupton se distancat e transportit dhe ndërhyrjeve nuk janë të paracaktuara, çka rrit

rrezikun dhe koston për operatorin ekonomik.

Çmimet e ofruara për këto pozicione (14.90 €/km, 15.75 €/km, 15.15 €/km, 16.25 €/km dhe

9.95 €/km) janë të diferencuara sipas llojit të shërbimit, peshës dhe kompleksitetit të

transportit, dhe përfaqësojnë çmime reale tregu që mbulojnë vetëm kostot bazike të

shërbimit. Në shumë raste, për distanca të shkurtra, këto çmime rezultojnë më të ulëta në

vlerë absolute, ndonëse angazhimi teknik dhe operacional është i njëjtë si për distanca më

të gjata.

Për ilustrim praktik, në rast se do të transportohej një pajisje me peshë mbi 35 ton në një distancë prej 15 km, sipas çmimit të ofruar për pozicionin C.1 (14.90 €/km), operatori ekonomik do të paguhej vetëm 223.50 € gjithsej, shumë kjo që përfshin ngarkimin, transportin dhe shkarkimin e pajisjes. Po ashtu, në rast se do të transportohej një kontejner në distancë prej 10 km, sipas pozicionit C.2 (15.75 €/km), kompensimi total do të ishte vetëm 157.50 €.

Në rastin e transportimit të mjeteve të palëvizshme me peshë minimale 10 ton me autobartëse kran, në një distancë prej 10 km, sipas pozicionit C.4 (16.25 €/km), pagesa totale do të ishte vetëm 162.50 €, pavarësisht kompleksitetit të ngarkimit dhe rrezikut operacional që mbart ky lloj shërbimi. Ndërsa për pozicionin C.5, transportimi i dheut të gërmuar, duke marrë parasysh se zakonisht realizohet në distanca të shkurtra prej 2–3 km, për një distancë prej 2 km kompensimi do të ishte vetëm 19.90 € për kamion me peshë ngarkese 20 ton, që praktikisht nënkupton rreth 1 € për ton të materialit të transportuar. Për këto arsye, çmimet e ofruara për pozicionet C.1 - C.5 janë ekonomikisht të arsyetuara, konkurruese dhe të favorshme për Autoritetin Kontraktues, dhe nuk mund të konsiderohen çmime jo-normalisht të larta, pasi reflektojnë kostot reale, rrezikun operacional dhe natyrën e shërbimeve të kërkuara.

Dhe në këtë kuptim në kushtet e përcaktuara për pjesëmarrje të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë AK nuk ka paraqitur asnjë kërkesë lidhur me ÇMIMET REFERENTE për pjesët e tenderit (sipas paramasës dhe paralogarisë së punëve) - Çmim TAVAN që përcakton nivelin minimal dhe maksimal të çmimit dhe OE duhet të mbështeten gjatë përgaditjes së ofertave financiare dhe që AK duhet të mbështetet gjatë kalkulimit dhe vlerësimit të tenderëve që do të ju shërbenin si mjet ndihmës.

Atëherë duke pasur parasysh se në dosjen e tenderit nuk janë paraqitur çmimet referente që OE duhet të mbështeten gjatë përgaditjes së ofertës financiare dhe poashtu nuk është i vendosur një min. apo max. i çmimit tavan siç është vendosur taveni i çmimit maksimum

në vlerën e parashikuar të kontratës, shtrohet pyetja se mbi cilën bazë është mbështetur dhe ka vendosur AK që ta vlerësojë një "çmim të lartë".

Poashtu sipas rendit kushtetues në Republikën e Kosovës, Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë dhe secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës. Andaj në këtë kuptim rendi kushtetues i RKS në kuadër të rregullimit ekonomik përcakton si bazike të drejtën e ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë duke siguruar një mjedis të favorshëm dhe ligjor për ekonominë e tregut dhe lirinë e aktivitetit ekonomik. Pra sipas parimit kushtetues por edhe legjislacionit pozitiv të Republikës së Kosovës autoritetet shtetërore në rastin kontret AK nuk ka të drejtë që të ndërhyjë dhe kontrollojë strategjinë dhe aftësinë konkurruese financiare me çmimet e tregut që i përcakton veprimi i ofertës dhe kërkesës në kushtet e konkurrencës, bazuar në gjykimin absolut dhe të pavarur të OE.

Andaj, të gjitha dokumentet e dorëzuara nga ana jonë janë të qëndrueshme, përputhen me kërkesat e dosjes së tenderit dhe dëshmojnë qartë kapacitetin teknik për zbatimin e shërbimeve të përcaktuara në këtë aktivitet të prokurimit.

Poashtu në lidhje me këtë kemi edhe shumë raste të gjykuara nga OSHP në lidhje me këtë çështje si vendimet me nr. 354/19, 752/19, 850/20, 1044/20, 224/22 , 306/22. Tek të gjitha këto vendime PSH e obligon AK-në që vlerësimi i ofertave të bëhet në çmim të tërësishëm dhe jo pozicione individuale në mënyrë që të bëjë konstatime nëse çmimi i ofruar është çmim i tregut.

Sa i përket eliminimit të OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, pajtohem me vendimin e AK-së pasi të gjithë rezultojnë të jenë të papërgjegjshëm.

Pretendimi i dytë (II)

Komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.1 të LPP-së dhe nenin 40.1 të RrPP-së, pasi është i obliguar që të vlerësojë dhe krahasojë vetëm tenderët e përgjegjshëm, duke u mbështetur në kriteret për dhënien e kontratës të përcaktuara në

njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Gjithashtu, sipas nenit 40.13 të RrPP-së, procesi i vlerësimit duhet të kryhet në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara paraprakisht dhe pa devijime nga kërkesat ligjore dhe dokumentacioni i tenderit. Në këtë rast, komisioni nuk ka respektuar këtë obligim, pasi ka përfshirë në proces edhe tenderë që objektivisht nuk ishin të përgjegjshëm dhe nuk përmbushnin kriteret teknike e administrative të kërkuara.

Kjo mënyrë veprimi ka ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin përfundimtar të aktivitetit të prokurimit dhe përbën shkelje të parimeve të ligjshmërisë, barazisë dhe trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë, të garantuara nga LPP.

Pretendimi i tretë (III)

AK ka bërë Shkelje të rëndë (Neni 97.1.o të RRPP-së) pasi me provat e mësipërme dëshmohet se kemi të bëjmë me sjellje të gabuar dhe jo profesionale të zyrtarit përgjegjës të prokurimit ndaj kompanisë sonë. Kjo pasi i njëjti është i obliguar sipas Nenit 39.4 të RrPP-së të organizoj punën e komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP.

Në këtë rast, edhe zyrtari përgjegjës ka dështuar të përmbushë këtë obligim ligjor, duke lejuar veprime dhe vendime që kanë cenuar parimin e ligjshmërisë, barazisë dhe trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së, ndonëse kompania jonë ka përmbushur të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, por megjithatë nuk është rekomanduar për kontratë.

5. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë se:

“Autoriteti kontraktues do t’i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojnë në mënyrë transparente.”

6. Paragrafi 6 i nenit 7 përcakton se:

“Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse.”

Prandaj, faktet dhe rrethanat e lartcekura vërtetojnë se vendimi i AK-së është i kundërligjshëm, pasi gjatë procedurës së vlerësimit është vendosur në dëm të tenderit/ofertës së OE ankues, duke na mohuar të drejtën e ligjshme për shpërblim me kontratë, pavarësisht faktit se kemi paraqitur ofertë të përgjegjshme dhe me çmimin më të ulët. Duke marrë parasysh se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e sipërpërmendura të LPP-së dhe akteve nënligjore, dhe se si pasojë e këtyre shkeljeve jemi dëmtuar drejtpërdrejt, pasi kemi paraqitur ofertë të përgjegjshme dhe kemi plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në FTD-në e këtij aktiviteti të prokurimit, kërkojmë nga OSHP që të marrë në konsideratë dhe të vlerësojë të gjitha faktet e paraqitura në këtë ankesë. Duke u udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë, barazisë, mosdiskriminimit, pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrje, i propozojmë AK-së që të marrë këtë:

#### VENDIM

? APROVOHET SI E BAZUAR ankesa e OE “ALL STONE SH.P.K.”

? ANULOHET Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i publikuar me dt. 27.02.2026 në ueb faqe të KRPP-së, dhe lënda të kthehet në RI-VLERËSIM.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente, dhe do të kërkojmë llogari përmes rrugëve ligjore

nga të gjitha palët që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit.

#### KRITERET PËR VLERËSIM

Dosja e Tenderit- FDT dhe specifikacioni teknik

#### RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - ALL STONE SH.P.K.

Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës 179/26 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues nga AK, ku sipas AK-së i njëjti ka ofruar çmime dukshëm më të larta se çmimet e tregut.

OE ankues ndër të tjera pretendon se :

*"Fillimisht para se të paraqesim dëshmitë tona në lidhje me këto pozicione ju njoftojmë se oferta jonë nuk mund të konsiderohet si ofertë jo-normalisht e ulët/lartë siç përcaktohet me Nenin 41.3 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik dhe nuk dihet qëllimi i AK-së se pse ofertën tonë e ka konsideruar si të tillë.*

*a) Pozicioni A.2. Hapja e kanaleve me paisje te renda Eskavator te peshave te renda minimum 25 tone. Ne qmim duhet te llogaritet transporti I makinerise deri ne vendin ku do te kryhen punimet,pra makineria e cila bene hapjen e kanaleve llogaritet qmimi vetem prej fillimit te kryerjes se punimeve.*

*Çmimi i ofruar njesi: 285.00€/orë.*

*Lidhur me pozicionin A.2, sqarojmë se bëhet fjalë për kontratë publike kornizë, për të cilën nuk është i njohur paraprakisht lokacioni i punimeve, kohëzgjatja e ndërhyrjes apo distanca e transportit të makinerisë, çka paraqet rrezik ekonomik të drejtpërdrejtë për*

*operatorin ekonomik. Në përshkrimin e pozicionit është përcaktuar qartë se në çmim duhet të përfshihet transporti i makinerisë deri në vendin e punimeve, ndërsa pagesa llogaritet vetëm nga fillimi i kryerjes së punimeve, pa u kompensuar koha dhe kostoja e transportit.*

*Eskavatorët me peshë minimale 25 ton kanë kosto të larta operative, duke përfshirë shpenzime të konsiderueshme të naftës (konsum i lartë për orë pune), servis të specializuar, amortizim të shpejtë të pajisjes si dhe kosto shtesë për transport me mjete të posaçme. Në praktikë, mund të kemi raste kur makineria transportohet në distanca deri në 80 km, ndërsa ndërhyrja në terren zgjat vetëm 1-2 orë, për çka operatori ekonomik paguhet vetëm për kohën e punës, p.sh. 570 € për 2 orë, ndonëse kostoja reale e shërbimit është dukshëm më e lartë.*

*Për më tepër, duhet pasur parasysh edhe rreziku që lidhet me lokacionin e zhvillimit të punimeve, përfshirë mundësinë e dëmtimit të pajisjes dhe rrethanat e paparashikueshme të sigurisë, të cilat paraqesin rrezik shtesë dhe mbesin përgjegjësi e operatorit ekonomik. Për këto arsye, çmimi i ofruar prej 285.00 €/orë është plotësisht i arsyetuar ekonomikisht, reflekton rrezikun, kostot reale dhe natyrën e kontratës kornizë dhe nuk mund të konsiderohet çmim jo-normalisht i lartë sipas legjislacionit në fuqi."*

OE ankues ppo ashtu sa i përket pozicioneve tjera të kontestuara nga AK potencon se :

*"Lidhur me pozicionet B.1, B.2, B.3 dhe B.4, sqarojmë se të gjitha këto pozicione kanë të njëjtën natyrë shërbimi, përkatësisht mbajtjen në posedim të pajisjeve të rënda, dhe jo përdorimin apo operimin aktiv të tyre. Në përshkrimin e secilit pozicion është përcaktuar qartë se çmimi llogaritet vetëm nga momenti i dorëzimit të makinerisë, ndërsa transporti, përgatitja teknike, mirëmbajtja, sigurimi dhe gatishmëria teknike mbesin barrë e operatorit ekonomik.*

*Mbajtja në posedim e pajisjeve të rënda (buldozer min. 30 ton, mjete transportuese min. 35 ton dhe pajisje për ngarkim min. 25 ton) nënkupton kosto të vazhdueshme dhe të*

*pashmangshme, duke përfshirë amortizimin e makinerisë, shpenzimet e mirëmbajtjes, sigurimin, personelin teknik në gatishmëri si dhe bllokimin e pajisjeve nga angazhime të tjera komerciale. Për më tepër, duke qenë se bëhet fjalë për kontratë publike kornizë, kohëzgjatja e mbajtjes në posedim nuk është e paracaktuar, çka rrit rrezikun ekonomik për operatorin ekonomik."*

Ak në refuzim të kërkesës për rishqyrtim potencon se të njëjtit kanë kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues, megjithatë xsqarimet e ofrrara nuk kanë qenë bindëse për AK-në.

Në përgjigje AK po ashtu ka ofruar një listë të pozicioneve të kontestuara, ku janë vendosur çmimet e parashikuara, nka ku del se çmimet e ofruara nga OE ankues janë nga 50% deri 100% se ajo qka parashikuar AK.

Kjo vlerësojmë se vë në rrezik mudnësinë për realizim të mirë të kontratës pasi AK mund të shpenzoj të gjithë buxhetin e këtij ajktiviteti pa arritur ti plotësoj nevojat e AK-së në tërësi.

Në rastin konkret vlerësojmë se mbetet në diskrecion dhe në përgjegjësi të AK-së vlerësimi i çmimeve të kontestuara dhe rekomandojmë të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

#### Pretendimi nr.2

Pretendimet nr.2 dhe nr.3 janë të se përmes shkerlejeve të AK-së (të cekura në pretendimin nr.1) AK ka bërë shkelje të tjera të LPP-së dhe legjislacionit sekondar si neni 59 i LPP-së si dhe neni 40.13 të RrPP-së dhe Neni 97.1.o të RRPP-s.

Mendimi ekspertit shqyrtues është se AK nuk ka bërë shkelje të dispozitave të lartëcekura.

#### REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtuar nga OE “ALL STONE SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “MARRJA ME QERA E MAKINERIVE TE RENDA” me numër të prokurimit: “214/30400-25-11613-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **ALL STONE SH.P.K.**

